

Momente të vështira për vendin tonë



Në këto momente të vështira për vendin tonë, por në mënyrë të veçantë për qytetin e Durrësit, Kisha jonë vazhdon solidarizimin, duke dhënë kontributin e saj:
Duke vizituar qytetarët, shtëpitë e të cilëve janë dëmtuar nga tërmeti,
Duke marrë informacion për shkallën e dëmtimit të tyre,
Duke u qëndruar pranë njerëzve e duke u dhënë kurajo morale e psikologjike,
Duke vizituar kampet e ngritura pranë stadiumit e duke kontaktuar strukturat organizuese për kontributin dhe ofrimin e një ndihme konkrete.
Nevojat për përballimin e kësaj situate janë të shumta. Në kontaktet me njerëzit kemi konstatuar se kanë nevojë për:

Mbështetje shpirtërore, psikologjike e morale,

Ndihmë financiare,

Ndihmë në ushqime dhe strehim në banesa të sigurta.

Me përkrahjen morale dhe mbështetjen financiare të Kryepiskopit Anastas, i cili që në orët e para të dt. 26 nëntor vizitoi shtabin e Emergjencave Civile, si edhe të dëmtuarit e strehuar në tenda, Kisha jonë për të dytën ditë radhazi ka hapur dyert e saj 24 orë, duke u kthyer në shtëpi pritjeje dhe qetësimi, duke strehuar natën e

parë rreth 30 persona dhe sot mbi 50 persona. Gjithashtu, në Manastirin e Shën Vlashit, dje u strehuan rreth 48 persona dhe sot strehohen mbi 76 persona, ku u ofrohet strehim, ushqim, si edhe u mbulohen të gjitha nevojat imediate për të kaluar këto momente të vështira.

Strukturat kishtare po punojnë pa ndërprerje në ofrimin e ndihmave dhe për t'u qëndruar sa më pranë qytetarëve të prekur.

[Kisha Orthodhokse “Apostull Pavli dhe Shën Asti”, Durrës/facebook](#)